

355 shpk

Pasqyrat Financiare dhe Shënimet Shpjegues 2019



Everything handled with care.

355 SHPK

Pasqyrat Financiare dhe Shënimet Shpjeguese

VITI 2019

Tabela e Përmbajtjeve:

	FAQE
PASQYRAT FINANCIARE:	
BILANCI KONTABEL	3
PASQYRA TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE	4
PASQYRA E FLUKSEVE MONETARE	5
PASQYRA E NDRYSHIMIT TE KAPITALIT	6
SHENIMET SHPJEGUESE TE PASQYRAVE FINANCIARE	7-18

**Pasqyra e Pozicionit Financiar
per periudhen 01 Janar – 31 Dhjetor 2019**

AKTIVI	2019	2018
AKTIVET AFATSHKURTERA		
Aktivete monetare	1,858,531	11,223,233
Nga aktiviteti i shfrytëzimit	141,000	918,277
Te tjera aktive afatshkurtra	762,812	130,825
Inventarët		
Mallra	11,924,783	10,852,142
Inventar I imet	508,520	431,453
Shpenzime të shtyra	18,777	22,225
TOTALI AKTIVEVE AFATSHKURTRA	15,214,423	23,578,155
AKTIVET AFATGJATE		
Aktivete materiale		
Të tjera Instalime dhe pajisje	2,914,511	1,365,943
TOTALI AKTIVEVE AFATGJATA	2,914,511	1,365,943
AKTIVE TOTALE	18,128,934	24,944,098
DETYRIMET DHE KAPITALI		
DETYRIME AFATSHKURTRA		
Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	15,255,315	18,126,014
Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve	821,419	251,114
Të pagueshme për detyrimet tatimore	468,301	1,335,485
TOTALI I DETYRIMEVE AFATSHKURTERA	16,545,035	19,712,613
DETYRIME AFATGJATA		-
TOTALI I DETYRIMEVE AFATGJATE		-
DETYRIMET TOTALE		
KAPITALI DHE REZERVAT		
Fitim / Humbja e Vitit	1,583,900	5,231,485
TOTALI KAPITALEVE TE VETA	1,583,900	5,231,485
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT	18,128,934	24,944,097

Këto Pasqyra Financiare janë përgatitur dhe aprovuar
në datën:

30.03.2020

Aprovoi (emer, firma): Lavdim Veshi



**Pasqyra e Pozicionit Financiar
per periudhen 01 Janar – 31 Dhjetor 2019**

AKTIVI	2019	2018
AKTIVET AFATSHKURTERA		
Aktivete monetare	1,858,531	11,223,233
Nga aktiviteti i shfrytëzimit	141,000	918,277
Te tjera aktive afatshkurtra	762,812	130,825
Inventarët		
Mallra	11,924,783	10,852,142
Inventar I imet	508,520	431,453
Shpenzime të shtyra	18,777	22,225
TOTALI AKTIVEVE AFATSHKURTRA	15,214,423	23,578,155
AKTIVET AFATGJATE		
Aktivete materiale		
Të tjera Instalime dhe pajisje	2,914,511	1,365,943
TOTALI AKTIVEVE AFATGJATA	2,914,511	1,365,943
AKTIVE TOTALE	18,128,934	24,944,098
DETYRIMET DHE KAPITALI		
DETYRIME AFATSHKURTRA		
Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	15,255,315	18,126,014
Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve	821,419	251,114
Të pagueshme për detyrimet tatimore	468,301	1,335,485
TOTALI I DETYRIMEVE AFATSHKURTERA	16,545,035	19,712,613
DETYRIME AFATGJATA		-
TOTALI I DETYRIMEVE AFATGJATE		-
DETYRIMET TOTALE		
KAPITALI DHE REZERVAT		
Fitim / Humbja e Vitit	1,583,900	5,231,485
TOTALI KAPITALEVE TE VETA	1,583,900	5,231,485
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT	18,128,934	24,944,097

Këto Pasqyra Financiare janë përgatitur dhe aprovuar
në datën:

30.03.2020

Aprovoi (emer, firma): Lavdim Veshi



**Pasqyra e Flukseve Monetare (Metoda Indirekte)
per periudhen 01 Janar – 31 Dhjetor 2019**

Nr	Përshkrimi	2019	2018
I	Fluksi I Mjeteve Monetare nga / përdorur në aktivitetin e shfrytëzimit		-
	Fitim / Humbja e vitit	1,964,530	6,156,834
II	Rregullime për shpenzimet jomonetare:		-
2	Shpenzime për tatim fitimin jomonetar	(380,631)	(925,349)
3	Shpenzimi konsumi dhe amortizimi	547,640	156,011
III	Fluksi I mjeteve monetare I përfshire në aktivitetet investuese:	(4,168,547)	7,357,691
2	Ndryshimet ne aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit	(4,168,547)	7,357,691
	a) Rënie / rritje në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	148,739	(1,071,327)
	b) Rënie/rritje në inventar	(1,149,708)	(11,283,595)
	c) Rritje/rënie në detyrimet e pagueshme	(3,167,578)	19,712,613
	d) Rritje/rënie në detyrimet për punonjesit		-
	<i>Mjete monetare neto nga/perdorur në aktivitetin e shfrytëzimit</i>	(2,037,007)	12,745,187
IV	Fluksi I Mjeteve Monetare nga / përdorur në aktivitetin e investimit		-
	c) Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(2,096,209)	(1,521,954)
	<i>Mjete monetare neto nga/perdorur në aktivitetin e investimit</i>	(2,096,209)	(1,521,954)
V	Fluksi I Mjeteve Monetare nga / përdorur në aktivitetin e financimit		-
	a) Arkëtime nga emetimi I kapitalit aksionar		
	b) Arkëtime nga emetimi I aksioneve të përdorura si kolateral		
	c) Hua të arkëtuara		
	d) Pagesa e kostove të transaksionit që lidhen me kreditë dhe huatë		
	e) Riblerje e aksioneve të veta		
	f) Pagesa e aksioneve të përdorura si kolateral		
	g) Pagesa e huave		
	h) Pagesë e detyrimeve të qirasë financiare		
	i) Interes I paguar		
	j) Dividendë të paguar	(5,231,485)	
	<i>Mjete monetare neto nga/perdorur në aktivitetin e financimit</i>	(5,231,485)	-
VI	Rritje / Rënie neto në mjetet monetare dhe ekuivalentë te mjeteve monetare	(9,364,701)	11,223,233
VII	Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare me 1 Janar	11,223,233	-
VIII	Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare me 31 Dhjetor	1,858,531	11,223,233

Aprovoi (emer, firma): Lavdim Veseli

**Pasqyra e ndryshimeve ne kapitalin neto
per periudhen 01 Janar – 31 Dhjetor 2019**

Pershkrimi	Kapitali I	Primi I lidhur me kapitalin	Rezerva				Fitimet e Pashperndara	Fitim / Humbja e vitit	Totali	Interesa Jo-	Totali
			Rivleresimi	Ligjore	Statutore	Te tjera					
Pozicioni financiar më 31 Dhjetor 2017	0						0	0		0	
a)Efekti I ndryshimeve ne politikat kontabël								0		0	
Pozicioni financiar me 1 Janar 2018								0		0	
Të ardhura totale gjithpërfshirëse per vitin							0	0		0	
a)Fitim / Humbja e vitit							5,231,485	5,231,485		5,231,485	
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse								0		0	
Totali I të ardhurave gjithpërfshirëse per vitin 2018	0	0	0	0	0	0	5,231,485	5,231,485	0	5,231,485	
Transaksionet me pronarët e njesisë ekonomike të njohura direkt në kapital										0	
a)Emetimi I kapitalit te nënshkruar										0	
b) Dividendë të paguar										0	
Totali I transaksioneve me pronarët e njesisë ekonomike										0	
Pozicioni financiar I rideklaruar më 31 Dhjetor 2018	0	0	0	0	0	0	0	5,231,485	0	5,231,485	
Pozicioni financiar I rideklaruar më 1 Janar 2019	0	0	0	0	0	0	0	5,231,485	0	5,231,485	
Të ardhura totale gjithpërfshirëse per vitin							0	0		0	
a)Fitim / Humbja e vitit							1,583,900	1,583,900		1,583,900	
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse								0		0	
Totali I të ardhurave gjithpërfshirëse per vitin 2019	0	0	0	0	0	0	5,231,485	1,583,900	0	6,815,384	
Transaksionet me pronarët e njesisë ekonomike të njohura direkt në kapital										0	
a)Emetimi I kapitalit te nënshkruar										0	
b) Dividendë të paguar							-5,231,485	5,231,485		5,231,485	
Totali I transaksioneve me pronarët e njesisë ekonomike										0	
Pozicioni financiar I rideklaruar më 31 Dhjetor 2019	0	0	0	0	0	0	0	1,583,900	0	1,583,900	

Aprovoi (emer, firma): **Laydim Veshi**



1. Informacion i përgjithshëm.

Shoqëria 355 Shpk është themeluar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit në 25 Janar 2018. Kapitali Themeltar i Shoqërisë është 200 lekë.

Shoqëria ka objekt aktiviteti: import - eksport, shitje pakice e pajisje elektronike celulare dhe elektrike, pajisje zyresh dhe kancelari, si dhe pajisje teknologjike. Servis dhe mirembajtje pajisjesh elektronike, celulare si dhe konsulenca te ndryshme, trajtime te ndryshme dhe sherbime te tjera.

Administrator i shoqërisë është Lavdim Veshi.

Selia kryesore e shoqërisë ndodhet në Tirane, Njësia Administrative nr.10, Rr. Myslym Shyri, Nd.44, H.1, 1001 dhe rregjistruar pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore me NUIS L81325057Q.

Pika të tjera në të cilat operon shoqëria janë:

- DURRES, Lagjja nr.4, Rruga P.Meksi
- TIRANE, Rruga e Kavajes, perballe Kishes Katolike, Pallati Nr.7, kati 1, Shkalla 1
- TIRANE, Kashar, Autostrada Tirane Durres, Rruga Dytesore km 2, tek QTU
- TIRANE; Rruga Sami Frasheri, ngjitur me KEMP, Kryqezimi i Myslym Shyrit;
- FIER; Rruga Kastriotet, Godina nr 14, Hyrja 3, Apartamenti 18
- TIRANE; Farke, Lunder, Rruga Tirane-Elbasan, Qendra Tregtare TEG, Kati 1

Shoqëria me 31 Dhjetor 2019 ka të punësuar 30 punonjës.

2. Përmbledhje e politikave kryesore kontabël të përdorura

2.1 Bazat e Përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK), duke përdorur metodën e kostos historike, e cila përfshin rregullat dhe interpretimet në përputhje me Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.2 Monedha Funktionale

Pasqyrat Financiare janë përgatitur bazuar në koston historike. Këto pasqyra financiare janë hartuar në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.3 Vlerësime dhe Gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrorjës gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të Shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve.

Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

Në veçanti, informacionet mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumatat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga Shoqëria.

2.4 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhen funksionale (Lek) me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e bilancit janë konvertuar në Lek, me kursin e këmbimit të asaj date. Fitimi ose humbja në monedhë të huaj në zërat monetare është diferenca që rezulton nga konvertimi i një numri të caktuar njësisish në monedhë të huaj në Lek me kurse të ndryshme këmbimi. Aktivet dhe pasivet jo monetare në monedhe të huaj janë konvertuar në Lek me kursin e këmbimit të datës së transaksionit, ndërsa ato që janë matur me vlerë të drejtë janë konvertuar në Lek me kursin në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat në monedhë të huaj që vijnë nga konvertimi në Lek janë njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

2.5 Instrumenta Financiare

Instrumentat financiarë jo - derivative përbehen nga llogaritë e arketueshme, paraja dhe ekuivalentet e saj, dhe llogaritë të pagueshme.

Instrumentat financiarë që përmbajnë një detyrim dhe element kapitali njihen ose si detyrime ose si kapital.

Instrumentat financiarë jo – derivative njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus, për instrumentat e mbajtur jo në vlerën e drejtë nëpërmjet cdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë.

Në vijim të njohjes fillestare, instrumentat financiarë jo-derivative maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare regjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të Shoqërisë mbi rrjedhjet e parasë së aktivit financiar ose kur Shoqëria transferon aktivin financiar të një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë rreziqet dhe përfitimet thelbësore të aktivit. Blerjet dhe shitjet të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare regjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të Shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Paraja dhe Ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentet e saj përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat afatshkurtra me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së rrjedhës së parasë, paraja dhe ekuivalentet e saj përfshijnë depozita me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogaritë e Arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provigjoni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar si dhe vonesa në pagesa, konsiderohen si tregues që llogaritë e arkëtueshme janë zhvlerësuar.

Shuma e provigjonit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të rrjedhjeve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me kosto.

Kreditë dhe huatë

Kreditë dhe huatë regjistrohen me shumën neto të marra. Çdo zbritje, prim apo diferencë të tjera midis të ardhurave neto dhe vlerës së rimarrjes amortizohen dhe përfshihen në koston financiare të kredisë të shpërndarë gjatë kohëzgjatjes së kredisë. Shpenzimet e interesit mbi kreditë llogariten në bazat e parimit të së drejtës së konstatuar. Kostot e huamarrjes regjistrohen si shpenzime kur ato ndodhin.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të parasë dhe ekuivalenteve të saj, llogarive të arkëtueshme dhe të pagueshme, dhe huave janë të ngjashme me vlerat e tyre kontabël neto për shkak të maturimit afatshkurtër ose normave të interesit të cilat i për afrohen normave të tregut.

2.6 Aktive Afatgjata Materiale

Njohja dhe Matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjen nga rënia në vlerë. Kostoja përfshin shpenzimet të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kosto e aktiveve të vete ndërtuara përfshin koston e blerjeve të materialeve, punën dhe çdo kosto tjetër që ka për synim të sjellë aktivet në kushte pune, koston e çmontimit dhe heqjen e elementëve, rregullimin e vendit në të cilin ato janë vendosur si dhe kostot e kapitalizuara të huamarrjes. Programi i blerë, i cili është i rëndësishëm në funksionimin e pajisjes së lidhur me të është kapitalizuar si pjesë e asaj pajisjeje.

355 shpk

Pasqyrat Financiare dhe Shënimet Shpjeguese 2019

Kur pjesë të aktivit kanë kohezgjatje të ndryshme ato kontabilizohen si aktive më vete (përbërësit më të mëdhenj) të grupit të aktiveve afatgjata materiale. Fitimet dhe humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit e një aktivi afatgjatë material përcaktohen në bazë të krahasimit midis të ardhurave nga nxjerrja jashtë përdorimit dhe vlerës së mbartur dhe këto fitime apo humbje njihen neto në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kosto Vijuese

Kosto e pjesës zëvendësuese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën e mbartur në qoftë se ka probabilitet që përfitimet ekonomike në të ardhmen do të gjenerohen nga ky aktiv dhe do të rrjedhin në Shoqëri, si dhe kosto e kësaj pjese të jetë e matshme në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të përditshme të pajisjeve dhe makinerive njihen në pasqyrën e të ardhurave kur ato ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi i makinerive dhe pajisjeve llogaritet duke përdorur metoden e vlerës së mbetur mbi jetën e çdo pjese të një aktivi që nga dita e parë e muajit që pason muajin në të cilin ai është blerë. Aktivet e dhëna me qira amortizohen përgjatë periudhës më të shkurtër midis kohës së dhënies me qira dhe jetegjatesisë së tyre. Toka nuk amortizohet.

Të gjitha aktivet materiale të Shoqërisë amortizohen me vlerën e mbetur dhe vetem aktivet jo materiale amortizohen me metodën lineare. Toka dhe shtëpitë e banimit (përfshirë shtojcat) nuk amortizohen. Normat vjetore të amortizimit janë si më poshtë:

	Në %
Mjete transporti	20
Pajisje dhe mobilje	20
Pajisje kompjuterike	25

Metodat e Amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur kontabel rishikohen çdo datë raportimi.

2.7 Aktive Financiare

Aktive Financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi dhe kur kjo mund të vlerësohet me besueshmëri.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbartur dhe vlerës aktuale të rrjedhjeve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normen efektive të interesit.

Aktivitetet financiare të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitetet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të rrezikut të kredisë.

Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitetet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Aktive jo financiare

Vlera e mbetur e aktiveve jo financiare të Shoqërisë, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla, atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Shuma e rikuperueshme është vlera më e lartë ndërmjet vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, rrjedhja e pritshme e ardhshme e parasë është skontuar në vlerën aktuale duke përdorur normen e skontimit që reflekton vlerën aktuale të parasë në treg dhe rreziqet specifike të aktivitetit për të cilat vlerësimet e rrjedhjeve të ardhshme të parasë nuk janë rregulluar.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

2.8 Provigjonet

Nje provigjon njihet nëse, si rezultat i një ngjarje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe ka mundësi që në të ardhmen do të duhen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij.

Shoqëria nuk ka njohur provigjone gjatë vitit financiar 2019.

2.9 Njohja e të Ardhurave

Të ardhurat nga shërbimet njihen në pasqyrën e performancës në momentin e përfundimit të shërbimit në datën e raportimit. Nuk njihen të ardhura me risk të lartë mosarkëtimi dhe me kostot respektive.

2.10 Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesi nga fondet e investuara në depozitat bankare dhe fitimet nga transaksionet në monedhë te huaj. Të ardhurat nga interesi njihen kur ato konstatohen. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet financiare nga huamarrjet, humbjet në monedhë të huaj dhe ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare përmes fitimit apo humbjes në vlerë të drejtë (nese ka). Të gjitha kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur ato ndodhin.

2.11 Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e vitit, i cili njihet drejtpërdrejt në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Tatimi i vitit është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore në fuqi në datën e raportimit **(2019: 15%)**

1. Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tij

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tij në 31 Dhjetor 2019 janë si më poshtë:

	2019	2018
Mjete monetare	1,858,531	11,223,233
Total	1,858,531	11,223,233

Përkatësisht në datën 31 Dhjetor 2019 vlera monetare në arkat e shoqërisë është 1,821,453 Lek ndërsa vlera monetare në llogaritë e saj bankare është 37,078 Lek

2. Të drejta të arkëtueshme

Të drejtat e arkëtueshme në 31 Dhjetor 2019 janë si më poshtë:

	2019	2018
Kliente nga aktiviteti kryesor	141,000	918,277
Total	141,000	918,277

Zëri i klientëve nga aktiviteti kryesor përfaqësohet nga klientet: Copier Computer Center me vlerën 16,000 Lek dhe MS Group sha me vlerën 125,000 Lek.

3. Parapagimi dhe shpenzimet e shtyra

Parapagimi dhe shpenzimet e shtyra për 31 Dhjetor 2019 janë si më poshtë:

	2019	2018
Kerkesa te tjera te arkëtueshme	762,812	130,825
Total	762,812	130,825

Zëri i kërkesave të tjera të arkëtueshme për vitin 2019 përfaqësohet nga, parapagimet për qera në vlerën 321,444 Lek, parapagime të tatimeve në vlerën 433,963 Lek si dhe paradhënie të tretëve për vlerën 7,405 Lek.

4. Pasqyra e Aktiveve Afatgjata Materiale dhe Jomateriale

	Mobilje dhe Paisje	Paisje IT dhe kompjuterike	Totali
<i>Kosto</i>			
Shtesa	1,464,874	57,080	1,521,954
Nxjerrje jashtë përdorimit			-
Gjendja më 31 dhjetor 2018	-	57,080	1,521,954
Shtesa	1,878,955	217,254	2,096,209
Nxjerrje jashtë përdorimit			-
Gjendja më 31 dhjetor 2019	1,878,955	217,254	3,618,163
<i>Zhvlerësimi i akumuluar</i>			
Gjendja më 31 Dhjetor 2018			-
Amortizimi i vitit	144,152	11,859	156,011
Sistemime			-
Nxjerrje jashtë përdorimit			-
Gjendja më 31 dhjetor 2018	144,152	11,859	156,011
Amortizimi i vitit	514,126	33,514	547,640
Sistemime			-
Nxjerrje jashtë përdorimit			-
Gjendja më 31 dhjetor 2019	658,279	45,373	703,652
<i>Vlera neto kontabël</i>			
Gjendja më 31 dhjetor 2018	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2019	1,220,676	171,881	2,914,512

5. Të tregtueshme dhe të tjera të pagueshme

Të tregtueshme dhe të tjera të pagueshme për 31 Dhjetor janë si më poshtë:

	2019	2018
Furnitorë	15,255,315	18,126,014
Detyrimet e listëpagesës	821,419	251,115
Detyrime Tatimore	468,301	1,335,484
Total	16,545,035	19,712,613

Detyrimi i furnitorëve në datën 31 Dhjetor 2019 për furnizime brënda vendit është 177,480 Lek dhe për furnitorë importi është 15,077,844 Lek.

Detyrimet e listëpagesës në datën 31 Dhjetor 2019 në vlerën 821,419 Lek, përbëhen nga zëri i detyrimit të pagave në vlerën 343,099 Lek dhe detyrimit të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore për muajin Dhjetor 2019 në vlerën 478,320 Lek.

Detyrimi tatimor në vlerën 468,301 Lek është në lidhje me TVSH e muajit Dhjetor 2019.

6. Kapitali i ortakëve

Ortakët e Shoqërise 355 Shpk janë Z. Lavdim Veshi me cilësinë e administratorit, i cili zotëron kuotën 50% të kapitalit dhe Z. Islam Veshi i cili zotëron kuotën 50% të kapitalit.

7. Të ardhurat nga shitja

Të ardhurat nga shitja për fundin e vitit 2019 janë si më poshtë:

	2019	2018
Të ardhura nga shitja	49,111,221	37,780,082
Të ardhura të tjera	140,210	182,890
Total	49,251,431	37,962,972

Zëri të ardhura të tjera nga shitja përfaqëson të ardhurat nga kursi i këmbimit.

8. Shpenzime Personeli

	2019	2018
Fondi i pagave bruto	12,544,706	5,833,785
Kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	2,022,931	916,293
Total	14,567,637	6,750,078

9. Shpenzime të tjera

	2019	2018
Blerje/shpenzime mallrash/sherbimesh	21,905,812	19,269,295
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	547,640	156,011
Shpenzime të tjera shfrytëzimi	10,191,085	5,177,274
Humbje nga KK	74,728	453,480
Total	32,719,265	25,056,060

Zëri i shpenzimeve të tjera shfrytëzimi deri më 31 Dhjetor 2019 përbëhet nga elementet e mëposhtëm:

	2019
Shpenzime qeraje	6,235,195
Shpenzime sigurie	296,000
Shpenzime financiare	875,004
Tarifa dhe taksa bashkiake	283,273
Shpenzime doganore	200,122
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	183,147
Shpenzime udhëtime dieta	370,903
Shpenzime mirëmbajtjeje nëpër pika shitje	1,747,442
Totali i shpenzimeve të tjera shfrytëzimi	10,191,085

Tatimi mbi fitimin

Kompania është subjekti tatimit mbi të ardhurat në Shqipëri, norma e tatimit mbi fitimin është 15% për vitin 2019. Formularët e deklaratave tatimore dorëzohen çdo vit, por të ardhurat dhe shpenzimet e deklaruara për qëllime tatimore konsiderohen deklarata auto derisa të shqyrtohen dhe vlerësohen nga autoritetet tatimore. Ligjet dhe rregullat tatimore shqiptare janë subjekti interpretimit nga autoritetet tatimore.

	VITI 2019	
	Te ushtrimit	Tatimore
Te ardhura	49,251,431	49,251,431
Shpenzime	(47,286,901)	(47,286,901)
Shpenzime te pazbritshme		573,007
<u>Fitimi / Fitimi tatimor</u>	<u>1,964,530</u>	<u>2,537,537</u>
Shpenzime tatim fitimi (15%)		380,631
<u>Parapagime</u>		<u>694,013</u>
<u>Tatim per tu paguar / mbipagese</u>		<u>(313,382)</u>

12. Detyrimet dhe përgjegjësitë.

Gjatë aktivitetit normal, Shoqëria nuk është e përfshirë në procedurat ligjore, pretendimet dhe proceset gjyqësore me pale të treta. Administratori beson se çdo ngjarje e mundshme e ardhshme nuk do të ketë një efekt të dëmshëm material mbi pozicionin financiar të kompanisë, rezultat e vetë operacioneve ose flukseve të mjeteve monetare.

13. Ngjarjet pas periudhes së raportimit

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pas datës së raportimit e cila kërkon rregullim ose dhënie informacionesh shpjeguese për këto pasqyra financiare.

* * *